



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:299272

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05843703

APS.nr.54/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti Special – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afërdita Bytyçi - kryetare e kolegjit, Bashkim Hyseni dhe Vatton Durguti - anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, në çështjen penale ndaj të akuzuarve: N.R, K.H, Sh.Z dhe E.Gj për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe ndaj të akuzuarve: Sh.M, L.Th, L.K dhe A.Z për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës, ankesat e mbrojtësve të akuzuarve N.R, av.Miograd Brkljac dhe K.P, av.Artan Qerkini, si dhe përgjigjet në ankesën e PS-së të ushtruara nga mbrojtësit e të akuzuarve Sh.M, av.Nuhi Paçarizi, L.K, av.Alban Makolli, L.Th, av.Fehmije Gashi Bytyqi dhe A.Z, av.Kushtrim Bytyqi, të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PS.nr.74/19, datë 01.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë: 25.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHEN si të bazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve N.R, av.Miograd Brkljac dhe K.P, av.Artan Qerkini, si dhe sipas detyrës zyrtare, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PS.nr.74/19, datë 01.06.2023, ashtu që të akuzuarit: **N.R dhe K.P:** konform nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP):

LIROHEN NGA AKUZA

Se gjatë vitit 2018 në Prishtinë, me qëllim që t'iu mundësojnë përfitim në mënyrë të kundërligjshme kompanive si: Konzorciumit “N...” sh.p.k, Konzorciumit “Dh...” sh.p.k, Konzorciumit “D.....”, si dhe Konzorciumit NTP “A.....E...” në P..., të akuzuarit në bashkëkryerje kanë tejkualuar kompetencat e tyre kanë vepruar në mënyrë të kundërligjshme, kanë keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare, duke shkelur me dashje dhe dijeni ligjet gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, ashtu që: i akuzuari N.R, në cilësinë e Ministrit në M...e B...P... dhe Zh... R...të Republikës së Kosovës, ka tejkualuar kompetencat e tij, ka hartuar një “Program të veçantë, pa buxhet të veçantë të ndarë për këtë program, ka vendosur mbi kriteret, ka përcaktuar regjionet për financim, shumën e grantit, duke i anashkualuar edhe procedurat e rregullta që ishin për hartimin e të programit të rregullt, që ishte kompetencë e Departamentit të Politikave të Zhvillimit Rural në MBPZHR, duke mbivendosur masa speciale me programin e veçantë që nuk përcaktoheshin me ligj dhe me programin e rregullt, në mënyrë kundërligjshme, në kundërshtim me nenin 5 dhe 8 të Ligjin për B.. dhe Zh.R Ligji nr.03 /L-98, nenin 5 par.1, 2, 3 dhe 4 të Ligjin nr. 04/L-090, nenin 2 të Ligjit nr. 06/L020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, nenin 30, 30.1, 30.2, 30.3, 30.4, 35.1 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike Ligjin nr. 03/L-048, me nenin 36, te Ligjit me nr. 03/L-221, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, me nenin 19.1 te Ligjit me nr. 03/L-221, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, si dhe në kundërshtim me 37 par. 37.1 te Ligjit me nr. 03/L-221, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, me datë 26.03.2018 e lëshon vendimin me nr. Ref. KM..., për hartimin e politikave të reja për zhvillimin e mëtejshëm të I...R...dhe ngritjes së konkurueshmërisë në zonat rurale më pak të zhvilluara, me ç’rast pas vendimit draftin për përgatitjen e programit ua dorëzon të përgatitur – të draftuar komisionit – grupit punues i cili komision ishte formuar vetëm formalisht kinse për hartimin e programit të veçantë, ashtu që këtë grup punues e kishte formuar i akuzuari N.R në bashkëpunim me të akuzuarin K.P, ashtu që: i akuzuari K.P në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm në M...e B...P... dhe Zh... R...të Republikës së Kosovës, nuk i përmbush detyrat e tij zyrtare, duke vepruar në kundërshtim me përgjegjësit e tij që janë përcaktuar me nenin 10, nënpar.10.1 dhe 10.2 nënpar. a, b, c, d, e, dhe nenin 10.3, me Ligjin për Menaxhimin e financave publike nr. 03/L-048, ku është përcaktuar se Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA), ka përgjegjësinë kryesore ligjore për të siguruar që organizata buxhetore, është shprehimisht përgjegjës për vendosjen e kontrollit të brendshëm në organizatën buxhetore, agjencinë autonome ekzekutive ose ndërmarrjen publike sipas Rregullave KMF, pra i akuzuari K.P duke vepruar në kundërshtim me përgjegjësit e tij, për të i’u mundësuar përfitim në mënyrë

të kundërligjshme kompanive të sipërcituara, ka tejkeluar kompetencat e tij duke vepruar në këtë mënyrë, në kundërshtim me nenin 2 par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të Ligjit nr. 03/L-189, që përcakton përgjegjësit e Sekretarit të Përgjithshëm, ashtu që duke vepruar në kundërshtim me këto dispozita ligjore ka nxjerr vendimin me Ref.nr...../18, në kundërshtim me përgjegjësit e tij, në atë mënyrë që emëron grupin punues në përbërje prej 11 anëtarëve, për përgatitjen e investimeve në infrastrukturë rurale, duke qenë në dijeni se ky grup nuk është kompetent dhe nuk ka njohuri për përpilimin e këtij programi, derisa ishte në dijeni se ky grup ishte vetëm formal, duke ditur se drafti është dorëzuar nga vet Ministri N.R, të gjitha këto në pajtim me të akuzuarin N.R me qëllim për t'iu mundësuar përfitim në mënyrë të kundërligjshme kompanive të lartshënuara, në këtë mënyrë, të akuzuarit buxhetit të Republikës së Kosovës në bashkëkryerje i kanë shkaktuar dëm në vlerë prej Euro.

Me këto veprime kishin për të kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par.1 dhe par.2 nënpar.2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

E dëmtuara - Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore – udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Shpenzimet e procedurës penale mbesin barrë e mjeteve buxhetore të Gjykatës.

II.REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.74/19, datë 01.06.2023, për pjesën liruese **VËRTETOHET**.

Pjesa e ankesës së PSRK-së lidhur me vendimin mbi dënimin për të akuzuarit N.R dhe K.P mbetet jo lëndore.

A r s y e t i m i

1. Historiku procedural

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, me aktgjykimin PS.nr.74/19, datë 01.06.2023, në pikën I të dispozitivit të akuzuarit N.R dhe K.P për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par.1 dhe par.2 nënpar.2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i ka shpallur fajtor dhe i ka gjykuar si në

vijim: Të akuzuarit N.R i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) vite, ndërsa të akuzuarit K.P i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite e gjashtë (6) muaj.

Të akuzuarve i'u është shqiptuar edhe dënim plotësues si në vijim: Të akuzuarit N.R, i ndalohej ushtrimi i funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik në kohëzgjatje prej tre (3) viteve, pas mbajtjes së dënimit me burgim të shqiptuar.

Ndërsa të akuzuarit K.P, i ndalohej ushtrimi i funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik në kohëzgjatje prej tre (3) viteve, pas mbajtjes së dënimit me burgim të shqiptuar.

Janë detyruar të akuzuarit që paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: ekspertizën financiare në mënyrë solidare shumën prej dymijë (2000) euro, për shpenzimet e paushallit gjyqësor secili veç e veç në shumën prej pesëqind (500) euro, si dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç në shumën prej njëqind (100) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit.

E dëmtuara Avokatura Shtetërore e Kosovës pranë Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Në pikën II të dispozitivit në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së: të akuzuarit Sh.Z dhe E.Gj i ka liruar nga akuza, pasi që nuk është provuar se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par.1 lidhur me par.31 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në llogarinë e mjeteve buxhetore.

E dëmtuara Avokatura Shtetërore e Kosovës pranë Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Ndërsa në pikën III të dispozitivit në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, të akuzuarit Sh.M, L.Th, L.K dhe A.Z, i ka liruar nga akuza, pasi që nuk është provuar se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në llogarinë e mjeteve buxhetore.

E dëmtuara Avokatura Shtetërore e Kosovës pranë Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

2. Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, dhe vendimit lidhur mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovojë ankesën si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta prishë ashtu që të akuzuarve N.R dhe K.P të i shqiptoj dënim më të lartë, ndërsa të akuzuarit E.Gj, Sh.M, L.Th, L.K dhe A.Z të i shpall fajtor dhe dënoj sipas dispozitave të KPRK-së, apo lëndën në këtë pikë t'ia kthej Gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.R, av.Miograd Brkljac, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit mbi dënim dënimin plotësues dhe shpenzimet e procedurës penale, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj ankesën si të bazuar, të ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, të akuzuarin ta liroj nga akuza, apo çështjen të kthej në rigjykim.

Mbrojtësi i të akuzuarit K.P, av.Artan Qerkini, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj si të bazuar ankesën, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, apo i njëjti të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesën e prokurorisë kanë ushtruar.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.M, av.Nuhi Paçarizi, me propozim që Gjykata e Apelit, të refuzoj si të pa bazuar ankesën e Prokurorisë Speciale, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.K, av.Alban Makolli, me propozim që Gjykata e Apelit, të refuzoj si të pa bazuar ankesën e Prokurorisë Speciale, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.Th, av.Fehmije Gashi Bytyqi, me propozim që Gjykata e Apelit, të refuzoj si të pa bazuar ankesën e Prokurorisë Speciale, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.Z, av.Kushtrim Bytyqi, me propozim që Gjykata e Apelit, të refuzoj si të pa bazuar ankesën e Prokurorisë Speciale, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokurori i Prokurorisë së Apelit me parashtrësën PPA/I.nr.12/2024, të datës 09.01.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, në atë mënyrë që të akuzuarit E.Gj, Sh.M, L.Th, L.K dhe A.Z të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit, apo aktgjykimi i akimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa të akuzuarve N.R dhe K.P të shqiptohet dënim më i lartë. Kurse ankesat e mbrojtësve të akuzuarve N.R, av.Miograd Brkljac dhe K.P, av.Artan Qerkini, si dhe përgjigjet në ankesën e PS-së të ushtruara nga mbrojtësit e të akuzuarve Sh.M, av.Nuhi Paçarizi, L.K, av.Alban Makolli, L.Th, av.Fehmije Gashi Bytyqi dhe A.Z, av.Kushtrim Bytyqi të refuzohen si të pabazuara

Gjykata e Apelit caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, në të cilën ka prezantuar të akuzuarit akuzuari N.R dhe K.P dhe mbrojtësit e tyre av.Miograd Brkljac dhe av.Artan Qerkini, si dhe të akuzuarit Sh.M, dhe mbrojtësi i tij av.Nuhi Paçarizi, i akuzuari L.K dhe mbrojtësi i tij av.Alban Makolli, i akuzuari L.Th, dhe mbrojtësja e tij av.Fehmije Gashi Bytyqi dhe e akuzuara A.Z, dhe mbrojtësi i saj av.Kushtrim Bytyqi, ndërsa nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit, i cili ka qenë i njoftuar me rregull për ditën dhe kohën e mbajtjes së seancës.

Mbrojtësit e të akuzuarve N.R, av.Miograd Brkljac dhe K.P, av.Artan Qerkini pasi elaboruan ankesën, theksuan se qëndrojnë pranë pretendimeve ankimore të paraqitura me shkrim, që i akuzuari të lirohet nga akuza, pasi që nuk është vërtetuar se kanë kryer veprën penale, ndërsa mbrojtësit e të akuzuarve Sh.M, av.Nuhi Paçarizi, L.K, av.Alban Makolli, L.Th, av.Fehmije Gashi Bytyqi dhe A.Z, av.Kushtrim Bytyqi, shpjeguan përgjigjet në ankesën e PTH-së propozuan që ankesa prokurorisë të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa të akuzuarit i mbështetin mbrojtësit e tyre.

3. Pretendimet ankimore të Prokurorisë Speciale dhe të mbrojtësve të akuzuarve

Prokurori në ankesë lidhur me pjesën liruese konsideron se gjykata nuk e ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, pasi që nuk është vlerësuar plotësisht deklarata e dëshmitares Shqipe Dema nga e cila deklaratë është vërtetuar në tërësi që i akuzuari E.Gj, si drejtor i departamentit ka udhëhequr programin dhe takimin, sipas se cilës i akuzuari Ekrem, projektin dhe programin e ka punuar vet dhe atë program përmes e-mailit u'a ka dërguar ministri. Po ashtu është vërtetuar, se iu kanë drejtuar me kërkesë përmes e-mailit ose drejtpërdrejtë drejtorit të

Departamentit Ligjor Sh.Z, se a mund të shndërrohen në Udhëzim Administrativ, ndërsa sipas kërkesës drejtori i departamentit ligjor Sh.Z është përgjigjur se “Programi i Veçantë nuk përcaktohet sipas ligjit për bujqësi”, dhe këtë përgjigje e kanë marrë edhe sekretari edhe ministri. Përveç kësaj edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve: F.B.K, B.H, T.A, S.H, I.C dhe H.Th është vërtetuar se asnjëri nga ata nuk ka dhënë kontribut në grupin punues për përgatitjen e programit të veçantë.

Nga të lartcekurat është vërtetuar se i akuzuari E.Gj, në cilësinë e personit zyrtar UD-krye shefit të AZHB-së, në mënyrë të kundërligjshme ka marrë vendimin ref.nr.AZHB-07/4/54/2018 për formimin e grupit punues, i cili do të bëjë kontrollin administrativ, vlerësimin, miratimin dhe kontraktimin e projekteve të masës së infrastrukturës rurale, në përbërje prej L.K, Sh. M., A.Z dhe L.Th, duke qenë në dijeni se ky grup ishte vetëm formal për veç kësaj ka anashkaluar faktin se ky grup duhet të formohet prej drejtorit dhe të raportohet tek Drejtori i Drejtorisë për Miratimin e Projekteve dhe Zhvillimit Rural, dhe kishte për qëllim që tu mundësonte përfitimin në mënyrë të kundërligjshëm kompanive si: Konzorciumin “N...” sh.p.k., Konzorciumin “Dh...” sh.p.k., Konzorciumin “D.....”, dhe Konzorciumin NTP “A..E” për fitimin e granteve në mënyrë të kundërligjshme, në këtë mënyrë të akuzuarit në bashkëveprim i kanë shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës dëm në vlerë prej 3.356.085,77 euro.

Tutje, lidhur me pjesën liruese ka shtuar se nga provat e administruara është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve Sh.M, L.K, L.Th, dhe A.Z, janë manifestuar elemente e veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kjo pasi që nga provat materiale, nga dosjet e Konzorciumeve “N...” sh.p.k, “Dh...” sh.p.k, “D.....” dhe NTP “A..E” është vërtetuar se asnjëra nga to nuk janë regjistruara në ARBK dhe AUV. Po ashtu sipas gjetjeve të raportit në faqen e parë çështja 3.A2 vërtetohet se është sipas udhëzimit administrativ UA 09/2018, neni 26 pika 4 se në rast se granti që kërkohet nga Ministria është 1.000.000 atëherë i aplikuari duhet të ofroj dëshmi se qarkullimi financiar tri vitet e fundit është 3.000.000..... Nga aplikimi për grante nga “Z.P” që kishte aplikuar në konzorcium me kompaninë “NTP RAD” kishte bashkangjitur vërtetimin që tregon se kompania kishte obligime të pa shlyera ndaj shtetit, nga dokumentet e “Dh...” sh.p.k. kishte prova që e njëjta nuk kishte pasur investime për projektin e fituar nga ministria, po ashtu katër përfituesit e kësaj mase iu kishte kaluar vlefshmëria e vërtetimit tatimor të lëshuar nga ATK. Në vlerësim të rrethanave të cituar gjykata në rastin e marrjes se aktgjykimit nuk i ka vlerësuar në mënyrë të plotë këto fakte të cilat po të vërtetoheshin të akuzuarit do të ishin shpallur fajtor, ashtu që me marrjen e aktgjykimit lirues gjykata e shkallës së parë ka bërë është shkeljen e ligjit penal.

Sa i përket vendimit për dënim për të akuzuarit N.R dhe K.P, thekson se dënimi është i butë në krahasim me përgjegjësinë e tyre si dhe me dëmin e shkaktuar, ka propozuar që të njëjtëve të i'u shqiptoj dënimi me të lartë, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Pretendimet ankimore të mbrojtjes

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit N.R, av.Miograd Brkljac, thekson se në rastin konkret, janë bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 pika 6 të KPP- së, që është arsye e mjaftueshme për anulimin e aktgjykimit, pasi ka ndikuar në marrjen e një vendimi të paligjshëm dhe të padrejtë. Duke shtuar se hartimi i një programi të posaçëm nga i akuzuari Rikalo, edhe pse të gjitha faktet dhe rrethanat e vërtetuara gjatë procedurës tregojnë se ai vetëm e ka firmosur atë, pasi që nuk është kontestuese se këtë draft e ka përpiluar i pandehuri E.Gj e po ashtu nuk diskutohet se drafti ka kaluar diskutimin e grupit punues, i cili praktikisht ka rezultuar me tekst përfundimtar në disa takime. Ndër të tjera ka theksuar se nuk kemi të bëjmë me bashkëkryerje nga neni 31 i KPRK-së, pasi mungojnë elementet e këtij instituti.

Shkelje e theksuar e dispozitave të procedurës penale konsiston edhe në dëmin që pretendohet se është shkaktuar, gjegjësisht, PSRK të pandehurin Rikalo, e akuzon se me nxjerrjen e vendimit për programin e veçantë i'u ka mundësuar kompanive:“N...”, “Dhemetre”, “SHP Z.P i A.....E...”, që në mënyrë të kundërligjshme të marrin grante për projektet e tyre në vlerë prej euro secila ose gjithsejtë ... euro, ashtu që në bashkëveprim me të pandehurit tjerë i ka shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në shuma prej ... euro. Nga kjo rrjedh se qëndrimi i PSRK-së, është në kundërshtim me vetveten, ajo e sheh si të dëmtuar vetëm buxhetin e Republikës së Kosovës, nga kompanitë që kanë marrë mjete nga buxheti. Në fund të fundit, nuk u kontestua se katër kompanitë kanë marrë gjithsejtë ... euro nga buxheti në emër të grantit për realizimin e të gjitha projekteve. Por ajo raporton dëm në buxhet shumë më të madh se euro. Ka kontestuar ekspertizën e përpiluar nga eksperti financiar

Andaj ky qëndrim i gjykatës së shkallës së parë bazohet jo vetëm në shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale, por edhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që ministri është autorizuar të marrë vendimin për politikën e reja të zhvillimit të I...R...dhe kjo del qartë nga neni 5 i Rregullores nr.02/2011 dhe tutje i referohet kësaj rregulloreje si dhe vendimit të Qeverisë së Kosovës më 27 janar 2018 e cila ka miratuar Planin e Reformave Ekonomike në të cilin titullohej “..... 71.74”, sipas së cilit gjendja në fushën e bujqësisë është e pakënaqshme dhe se për këtë arsye është e nevojshme të zbatohen plane reformuese prioritare dhe se për këtë qëllim vetëm për vitin 2018 është siguruar një buxhet prej euro, atëherë është

e qartë se ky Plan i Qeverisë, në fakt ishte obligim ligjor për MBPZHR dhe se Vendimi për politikat e reja dhe Programi i Veçantë për Zhvillimin e I...R...ishin në përputhje të plotë me Planin e Qeverisë së Kosovës. Veprimi i kundërt i ministrit në një situatë të tillë ligjore do të nënkuptonte mosrespektim të akteve ligjore të Qeverisë dhe përgjegjësi për atë mospërputhje.

Ka theksuar se programe speciale për zhvillimin e bujqësisë ishin miratuar edhe në vitin 2013 dhe 2014, kur ministër ishte z. Stavileci dhe në vitin 2019, kur ministre u bë Dijana Zhiviq dhe askush nuk e kishte problem për këtë, përveç kësaj në të tri rastet në fjalë, Departamenti Ligjor nuk ka konstatuar se ka pasur ndonjë gjë në kundërshtim me Ligjin për Bujqësi në zhvillimin e programeve të tilla. Duke theksuar se marrja e vendimit për politikat e reja, e më pas edhe miratimi i programit veçantë të kontestuar, nuk është në kundërshtim me ligjin, sepse ajo nuk është ndaluar me ligj.

Në Buxhetin për vitin 2018 nuk ishin të destinuara vetëm për zbatimin e Programit të Rregullt dhe Plani i Qeverisë së Kosovës për Reformat Ekonomike pas miratimit të tij u bë bazë ligjore dhe obligim ligjor për fillimin e zbatimit të Planit Zhvillimor të I...B..., i cili nuk ishte pjesë e programit. Në dokumentin e lartpërmendur të Qeverisë së Kosovës është përshkruar në mënyrë të qartë se janë siguruar mjete për realizim në vlerë prej 16 milionë euro, dhe është thjesht e pabesueshme se si gjykata ka marrë për bazë pretendimin e ekspertit F... se nuk ka pasur të buxhetuara, fonde për një program të veçantë.

Thelbi i kësaj çështjeje mund të reduktohet në faktin se pa asnjë dyshim u konstatua se MBPZHR, në fund të vitit 2018 kishte kthyer pothuajse plot 3.000.000 euro në buxhet, kështu që pretendimi i ekspertit financiar se fermerët nuk kanë mundur të dëmshpërbleheshin dyshohet se janë dëmtuar, është krejtësisht e pakuptimtë të thuhet se subvencionet nuk janë paguar sepse nuk ka pasur para në buxhet, pra janë shpenzuar për programin e diskutueshëm.

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit K.P, av.Artan Qerkini, thekson se në këtë çështje penale ligji penal është zbatuar në mënyrë të gabuar, sepse në veprimet e të akuzuarit Halimi nuk manifestohen elementet e veprës penale nga neni 422 të KP-së, po ashtu gjykata gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, sepse gabimisht ka vlerësuar se K.P ka nxjerr një vendim të kundërligjshëm për formimin e grupit punues për hartimin e një Programi të Veçantë, synimi i të cilit ka qenë përfitimi i Kompanive përfituese të granteve. Po ashtu gjykata ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të KPP-së, sepse vendimi i saj është kundërthënës, e po ashtu Gjykata nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare.

Lidhur me shkeljet e ligjit penal thekson se veprimet inkriminuese të akuzuarit K.H sipas prokurorisë në drejtim të veprës penale nga neni 422 të KPRK-së janë: 1.Nxjerra e Vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e programit të veçantë për infrastrukturën rurale dhe 2. Dijenia e tij se grupi punues është vetëm formal. Sipas mbrojtjes, nxjerrja e vendimit për formimin e grupit punues nuk përbën shkelje ligjore, përkatësisht shkelje të Ligjit për Administratën Shtetërore. Përkundrazi, nxjerrja e vendimit për formimin e grupit punues është në harmoni të plotë me nenin 38 par 2.2 të këtij ligji, sipas të cilit: “Sekretari siguron që vendimet e politikave dhe masat tjera të ministrisë të zbatohen në mënyrë efikase dhe efektive”. Pra, në bazë të ligjit, Sekretari siguron zbatimin e vendimeve për politikën, e në rastin konkret për politikën bujqësore. Duket qartë se kjo dispozitë ligjore, nuk e obligon atë, ti vlerësoj politikën, por se ai në bazë të kësaj dispozite duhet vetëm të zbatoj politikën. Për rrjedhojë i vetmi interpretim i mundshëm i nenit 38 par 2.2. të Ligjit për Administratën Shtetërore (Ligji 03/1.-189) është se K.P me nxjerrjen e Vendimit nr. ../18 ka vepruar në kuadër të kompetencave të tija të përcaktuara me ligj.

Gjykata ka dështuar të analizojë kornizën e plotë ligjore mbi bazën e së cilës funksionon dhe vepron Ministria e Bujqësisë. Kështu, Gjykata nuk i ka dhënë kurrfarë rëndësie dispozitave të Rregullores nr. 09/2011 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Dispozitat e kësaj Rregullore, të cilat është dashur të merren parasysh nga Gjykata janë siç përcaktohet në nenin 1-Qëllimi, nenin 2-Fushëveprimi dhe nenin 3-Përkufizimet si dhe nenin 49-Përgaditja e dokumenteve strategjike, me gjerësisht si në ankesë që sipas kësaj rregullore përcaktohen në mes tjerash edhe rregullat për hartimin dhe rekomandimin e politikave, ashtu që pikërisht, duke i zbatuar këto dispozita Ministria e Bujqësisë e ka pas për obligim të zbatojë edhe Programin për Reforma Ekonomike të Qeverisë së Kosovë të vitit 2017 dhe 2018 në të cilin në mënyrë shprehimore janë parashikuar masat e veçanta për përmirësimin e infrastrukturës rurale. Prandaj Gjykata gabimisht konstatimin e saj për kundërligjshmëri të veprimeve të akuzuarit K.P e mbështet në opinion e drejtorit të departamentit ligjor të MBPZHR Sh.Z, i cili po ashtu ka qenë i akuzuar në këtë çështje penale.

Gjykata nuk tregon se në cilën dispozitë të Ligjit për B.. dhe Zh.R (Ligji ...), e mbështet qëndrimin e vet se politikën bujqësore duhet që vetëm dhe ekskluzivisht të aprovohen nga Departamenti për Politika Bujqësore, i udhëhequr nga dëshmitarja Shqipe Dema.

Për më shumë, në elementin subjektiv (gjendjen mendore) të K.P, se po e ndërmer një veprim të ligjshëm, ka ndikuar edhe fakti se masa të veçanta ka pas edhe në vitin 2013, e po ashtu edhe financimi i projekteve të USAID “Masat pemore”, ka qenë masë e veçantë. Asnjëherë këto masa

të veçanta nuk kanë qenë kontestuese në aspektin ligjor, fakt ky që e ka përforcuar bindjen e të akuzuarit se është duke vepruar brenda kornizave ligjore.

Lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par 2 nën par 2.1 në lidhje me nenin 133 të KPP-së thekson se në këtë çështje penale Gjykata ka urdhëruar ekspertizë financiare megjithatë, problemi shfaqet në faktin se eksperti është angazhuar nga gjykata për të vërtetuar fakte të cilat nuk janë pjesë e dispozitivit të aktakuzës.

Kështu, eksperti është angazhuar që në raport me pikën I dhe II të dispozitivit të aktit akuzues, të jap mendim profesional ekspertizë lidhur me këto fakte: Analiza Buxhetore (duke përfshi por pa u kufizuar në dokumente: Ligjin për buxhetin e vitit 2018, kufijtë buxhetor, kërkesën buxhetore, kornizën afatmesme të shpenzimeve, PC Financiare (në veçanti të kategorisë-kodit buxhetor subvencione dhe transfere), Planin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2018, Planin Strategjik të MBPZHR-së i cili përfshin vitin 2018, Programin e Rregullt të Zhvillimit Rural për vitin 2018 “Programin e Veçantë” dhe dokumente të tjera të nevojshme për ekspertizë; Të përcaktohet për vitin 2018 sa ka qenë shuma e ndarë e buxhetit për secilën kategori; Sa ka qenë shuma e ndarë buxhetore sipas Ligjit për buxhet të vitit 2018 për zbatimin e Programit të Rregullt të Zhvillimit Rural dhe prej cilave njësi kërkuese kanë ardhur kërkesat me të cilat është miratuar buxheti për këtë program; grantët në cilën kategori buxhetore hyjnë etj.

Bëhet e qartë se pretendimi fillestar i Prokurorisë ka qenë se K.P në mënyrë të kundërligjshme e ka nxjerr vendimin Ref .nr. ZSP 266/18, e që në fakt nuk ka lidhje me faktet të cilat është kërkuar të vërtetohen përmes ekspertizës financiare.

Kurse në faqe 78-79, gjykata vërteton dy fakte: 1) Programin e veçantë (objekt akuze) ka ndikuar që të mos realizohen masat e aprovuara nga MBPZHR-ja dhe dëmtimi i fermerëve të cilëve iu janë aprovuar programet- projektet sipas programit të rregullt të zhvillimit rural të vitit 2018. Konstatimet si më lartë, bien ndesh me dëshminë e Drejtorit të Financave të MBPZHR-së, të pasqyruara në fq. 36 të aktgjykimit të cilat gjykata nuk i ka vlerësuar fare e ku në mes tjerash dëshmitari thekson “nga buxheti i alokuar dhe buxheti i shpenzuar në kategorinë ekonomike, subvencione dhe transfere “, ka pasur mjete të lira 2 milion e 988 744.61 euro.

Shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në atë se dispozita e nenit 369 par.7 të KPPK-së përcakton obligimin e gjykatës që në pjesën arsyetuese të aktgjykimit duhet që “në mënyrë të veçantë vlerëson provat kundërthënëse. Gjykata ka pranuar administrimin e provave

të dorëzuara nga mbrojtja të cekura si në ankesë, por të njëjtat vetëm i ka përmend si të administruara, nuk e ka bërë vlerësimin e tyre.

Lidhur me vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, gjykata gabimisht e ka vërtetuar lartësinë e dëmit të cilën ajo e konstaton në lartësi prej 3,356.085.77 euro. Dëmi do të mund të provohej vetëm nëse fermerët do ta padisnin MBPZHR-në për dëmin e pësuar e Gjykata në procedurë civile të detyronte Ministrinë të kompensoj dëmin fermerëve duke përfshi kamatat ligjore. Një gjë e tillë nuk ka ndodhë, prandaj konstatimi se është dëmtuar buxheti nuk gjen mbështetje në asnjë provë të administruar në shqyrtimin kryesorë.

Tutje ka shtuar se Gjykata gabimisht ka vërtetuar edhe faktin se K.P ka vepruar me qëllim që Konzorciumet "N..." sh.p.k; "Dh..." sh.p.k; "D....."; "A....E...." NTP të realizojnë dobi pasurore. Gjykata pa bërë asnjë lidhje kauzale në mes të Vendimit të Sekretarit për formimin e grupit punues Ref.ZPS dhe përfitimit të kompanive gjen se me formimin e grupit punues jo kompetent i akuzuari K.P ka pas qëllim që Konzorciumet e lartcekura të përfitojnë në formë të ndarjes së granteve.

4. Përgjigjet në ankesë të mbrojtësve

Në përgjigje në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit Sh.M, av.Nuhi Paçarizi, thekson se sipas ankesës së prokurorisë se i akuzuari kishte pasur për kompetencë shpalljen e fituesit të konzerciumeve nuk qëndron, pasi që i njëjti kishte në kompetencë vetëm vlerësimin e dosjeve në aspektin administrativ, për më tepër që nuk ka ndonjë provë që e vërteton faktin se janë shpallur përfituese ato konzerciume. Pretendimet se konzerciumet duhet të jenë të regjistruara në ARBK si shoqëri tregtare nuk qëndron, pasi që me ligjin për shoqëri tregtare përcaktohet qartë llojet e shoqërive tregtare të cilat duhet të regjistrohet, dhe konzorciumet nuk parashihet se duhet të regjistrohen si të tilla, si dhe pretendimet që të njëjtat nuk i kanë plotësuar kërkesat apo dëshmitë e qarkullimit financiar nuk qëndrojnë, pasi që të gjitha shkresat kanë qenë të rregullta.

Në përgjigje në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit L.K, av.Alban Makolli, thekson se aktgjykimi i ankimuar është i drejtë dhe i ligjshëm në tërësi, dhe se gjykata ka dhënë arsye të qarta, kuptimplotë, të mjaftueshme në arsyetimin e saj, pasi që nuk është provuar që i akuzuari ta ketë kryer veprën penale, dhe se pretendimet ankimore të prokurorisë nuk qëndrojnë. Nuk është vërtetuar tejkalimi i autorizimeve apo kompetencave, dashja për tejkalimin e kompetencave, dashja për përfitim të paligjshëm për vete apo personin e tretë, apo shkaktimin e ndonjë dëmi nga i akuzuari. Për më tepër që Prokuroria Speciale në ankesë, në mungesë të qëndrueshmërisë së pretendimeve ka ngritur çështje të tjera të cilat nuk përkojnë me objektin e akuzës.

Në përgjigje në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit L.Th, av.Fehmiye Gashi, Bytyqi, thekson se ankesa e Prokurorisë Speciale është e pabazuar, pasi që në të njëjtën lidhur me të akuzuarin vetëm citohet se nga provat e administruara është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale, pa e specifikuar se cili ishte veprimi eventual i kundërligjshëm i tij. Sipas mbrojtjes aktgjykimi i shkallës së parë është i drejtë, pasi që nuk është përcaktuar forma e kryerjes së veprës penale, dhe nuk është mundur të vërtetohet elementi subjektiv apo objektiv i saj.

Në përgjigje në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit A.Z, av.Kushtrim Bytyqi, thekson se pretendimet e prokurorit nuk qëndrojnë, pasi që të gjithë aplikuesit e grandeve kanë qenë të regjistruar në ARBK individualisht, ndërsa veprimtarinë mbi dy vjeçare dhe regjistrimet në AUV i kanë plotësuar përmes partnerëve të konsorciumit, në bazë të kontratave të konsorciumit, ndërsa konsorciumet si entitete të veçanta juridike nuk janë të obliguara të regjistrohen, nuk lejohet regjistrimi i tyre në ARBK. Më tutje vlerësimi i dokumenteve të aplikacioneve të granteve ka kaluar së pari nga komisioni punues pjesë e të cilës ka qenë e akuzuara, e pastaj kanë kaluar në proces të verifikimit nga Drejtori i Miratimit, si dhe tek inspektorët e AZHB-së, të cilët kanë vërtetuar në terren gjendjen financiare dhe përmbushjen e kriterëve sipas kontratave të përfituesve, dhe të njëjtit nuk kanë gjetur ndonjë vërejtje.

5. Të gjeturat e Gjykatës së Apelit

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 paragrafi 1 të KPP –së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore konstatoi:

- ankesa e mbrojtësve të akuzuarve N.R dhe Kaplan Halimi të paraqitur nga mbrojtësit e tyre, janë të bazuara, dhe të akuzuarit lirohen nga akuza, siç është cekur më lart, kurse ankesa e Prokurorisë lidhur me pjesën liruese është e pabazuar, ndërsa pretendimet për vendimin mbi dënim për pjesën dënuese mbasin jo lëndore.

Me aprovimin e ankesave të mbrojtësve të akuzuarve N.R, av.Miograd Brkljac dhe K.P, av.Artan Qerkini dhe duke vepruar sipas detyrës zyrtare, Kolegji konstaton se me aktgjykimin e ankimuar për pikën I të dispozitivit është shkelur ligji penal në kuptim të nenit 385 par.1.4 të KPP-së, pasi mbi gjendjen faktike të vërtetuar që është objekt shqyrtimi është zbatuar ligji penal material nga neni 422 par.1 dhe par.2 nënpar.2.1 dhe 2.2 të KPRK-së - vepra penale keqpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar i cili nuk ka mundur të zbatohet, si dhe janë shkelur dispozitat nga neni 384 par.2.7 lidhur me dispozitën e nenit 369 par.7 të KPP-së, pasi mungon

arsyetimi lidhur me faktet dhe rrethanat vendimtare nga të cilat do të derivonte përgjegjësia penale e të akuzuarve, në bazë të së cilave do të vërtetohet se të akuzuarit kishin vepruar me synim që të përfitonin personat e tjerë, ky fakt është i natyrës vendimtare, tipar esencial, dhe i domosdoshëm i veprës penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit, figura e së cilës kërkon nga kryerësi të veprës me “ me qëllim të nxjerrjes së përfitimit të kundërligjshëm për veten e tij ose të saj apo për ndonjë person tjetër ose organizatë tjetër ose për t'i shkaktuar ndonjë dëm personit apo organizatës tjetër”, në kontekst të kësaj çështje me qëllim të sigurimit të përfitimit personave të tretë.

Nën dritën e rrethanave konkrete të çështjes, Kolegji çmon se nga provat e zbatuara, të trajtuara dhe analizuara si në mënyrë inividuale, në lidhshmërinë tyre reciproke si dhe në unitetin e përgjithshëm nuk mbështesin përfundimet e gjykatës së shkallës së parë: “...që të akuzuarit në kundërshtim me ligjin për B.. dhe Zh.Rkanë hartuar programin e veçantë, i cili kishte për qëllim që t'i mundësonte përfitimin në mënyrë të kundërligjshëm kompanive si: Konzorciumin “N...” sh.p.k., Konzorciumin “Dh...” sh.p.k., Konzorciumin “D.....”, dhe Konzorciumin NTP “A..E” për fitimin e granteve duke i shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës dëm në vlerë prej euro”, si rrjedhojë nga rezultati provues nuk është konstatuar ekzistimi i ndërlidhjes në mes së veprimeve të akuzuarave se kishin për qëllim për të i'u mundësuar përfitim të kundërligjshëm këtyre kompanive, si pasojë një konkludim i tillë në aktgjykimin e atakuar ka mbetur në nivel hipotetik.

Kolegji rikujton se në kuptim të nenit 369 par. 7 të KPP-së, gjykata duhet të paraqet në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyes i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, se mbi bazën e cilave fakte konkrete vërtetohet që veprimet e të akuzuarit ishin të motivuara t'i sjellin përfitim personave të tretë, në rastin e caktuar kompanive përfituese të përshkruara në aktakuzë dhe aktgjykim.

Kolegji është i mendimit se nuk mjafton vetëm lidhja objektive mes hartimit të programit të veçantë të bujqësisë, shkeljeve të dispozitave ligjore dhe përfitimit të kompanive, të cilat kanë qenë përfitues të këtyre granteve. Mes këtyre veprimeve duhet të ekzistoj edhe lidhshmëria subjektive “komponenta subjektive tek të akuzuarit”, se të njëjtit këto veprime i kishin ndërmarrë për të krijuar përfitime të paligjshme kompanive të sipërmendura, andaj nga segmenti ligjor kërkohet që ky aspekt të provohet, në mënyrën që të vërtetohet se a ekzistonin lidhje, raporte të akuzuarave me këto kompani, dhe cilat janë faktet dhe prova që dëshmojnë këto relacione?

Sipas Kolegjit, gjendja e fakteve na jep një pasqyrë se nuk janë provuar faktet e rëndësishme, se të akuzuarit me veprimet e tyre inkriminuese kishin qëllimet e cituara më sipër, që

karakterizojnë dhe janë të domosdoshme të ekzistojnë për veprën penale që është objekt i akuzës dhe i aktgjykimit.

Nga faktet e çështjes, rrjedh se i akuzuari në N.R në cilësinë e Ministrit në M...e B...P... dhe Zh... R...të Republikës së Kosovës, me datë 26.03.2018 nxjerrë vendimin me nr. Ref. .. për hartimin e politikave të reja për zhvillimin e mëtejshëm të I...R...dhe ngritjes së konkurrencshmërisë në zonat rurale më pak të zhvilluara, me ç’rast pas vendimit, draftin për përgatitjen e programit u’a dorëzon – të draftuar komisionit – grupit punues.

Çështja që parashtrohet për diskutim, është nëse ky vendim për këtë program të veçantë bujqësor, kishte qëllim kriminal, që të i’u siguronte përfitime të paligjshme kompanive: Konzorciumit “N...” sh.p.k, Konzorciumit “Dh...” sh.p.k, Konzorciumit “D.....”, si dhe Konzorciumit NTP “A.....E...” në P....., dhe nuk kishte qëllim zhvillimin e I...R...dhe ngritjes së konkurrencshmërisë në zonat rurale më pak të zhvilluara?

Në këtë aspekt, pyetja themelore vijuese në sensin logjik që parashtrohet është:

Cilat janë provat që dëshmojnë dijeninë e të akuzuarit, me rastin e hartimit të këtij programi, se në konkursin dhe procedurat e përcaktuara për fitimin e granteve do të aplikojnë pikërisht kompanitë: Konzorciumit “N...” sh.p.k, Konzorciumit “Dh...” sh.p.k, Konzorciumit “D.....”, si dhe Konzorciumit NTP “A.....E...” në P....., dhe do të fitojnë grantet?

Kolegji ka në konsideratë pretendimet e mbrojtjes të cila vënë në pah detyrimet që janë në kuadër të kompetencave të ministrit, të përshkruara në të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, që rregullon fushën e veprimeve të zyrës së kryeministrit dhe ministrave, përcaktohet se:

Në nenin 1 paragrafi 1.1 dhe 1.2, ministrat propozojnë politikën të cilët e udhëheqin ministrinë të cilës i takon;

Neni 9 paragrafi 1.1 punon dhe e mbikëqyre zbatimin e politikave të ministrisë;

Neni 9 paragrafi 1.3 siguron ndarjen më të përshtatshme dhe transparente të fondeve që i marrin nga buxheti i Kosovës dhe nga burimet e tjera.

Nga rregullativa e sipërcekur, derivon se ministri është personi i cili është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave të ministrisë, dhe mbrojtja nxjerrë përfundimin se në këtë aspekt në kuadër të përgjegjësisë së tij edhe miratimi i programit për zhvillim e I...R...nuk rezulton që i njëjti ti ketë tejkaluar kompetencat e tij.

Kolegji dëshiron të rikujtoj, një çështje thelbësore për kërkesën ligjore për ekzistimin e përgjegjësisë penale në raport me veprën për të cilën janë akuzuar dhe shpall fajtor, edhe nën supozimin se programi për masat e veçanta për zhvillim bujqësor, të jetë marrë me shkeljen e dispozitave ligjore të cituara në aktakuzë dhe aktgjykim, për arsye të ekzistimit të veprës penale keqpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 dhe par.2 nënpar.2.1 dhe 2.2 të KPRK-së, tek vendimet dhe veprimet e të akuzuarave kërkohet dhe është e domosdoshme të ekzistoj “qëllimi kriminal”, që shkeljet e cituara ligjore, të jenë bërë me dashje e në funksion që të i’u sigurojnë kompanive të sipërmendura përfitime të jashtëligjshme, përderisa nuk ekziston, nuk manifestohet dhe nuk provohet ky qëllim, shkeljet eventuale ligjore sa do të numërta që mund të jenë, mbesin jashtë domenit të juridiksionit penal, rrjedhimisht kjo paraqet edhe kufirin ndërmjet përgjegjësisë penale dhe atyre jo penale.

Kolegji gjen se në raport me të akuzuarin K.P, i cili me datë 03.04.2018, në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë Bujqësisë, Zhvillimit Rural, i akuzuari me anë të vendimit me numër nr.1257, kishte formuar grupin punues në përbërje prej 11 anëtarëve, si vijon: D. Ll, kryesuese e grupit punues, Sh, D, anëtare, D.P anëtarë, Sh. Z, anëtarë, S H, anëtare, H. Th, anëtarë, I.C, anëtarë, E.Gjj, anëtarë, T. A, anëtarë, F.B- K, anëtare, dhe B.H, anëtarë, që kishte për detyrë përgatitjen e investimeve në infrastrukturën rurale në Kosovë dhe grupi duhej të fillonte punën menjëherë dhe grupi punues do të duhej të hartonte raport pune për sekretarin e përgjithshëm MBPZHR-së.

Nxjerrja e vendimit për formimin e grupit punues në vehten e saj nuk përbënte shkelje ligjore, përkatësisht shkelje të Ligjit për Administratën Shtetërore, dhe mund të koncipohet në harmoni me nenin 38 par 2.2 të këtij ligji, sipas të cilit: “Sekretari siguron që vendimet e politikave dhe masat tjera të ministrisë të zbatohen në mënyrë efikase dhe efektive”. Sekretari siguron zbatimin e vendimeve për politikën, e në rastin konkret për politikën bujqësore.

Për rrjedhojë, sipas aktakuzës dhe aktgjykimit, i akuzuari ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare, duke i tejkaluar kompetencat e tij, “ të gjitha këto në pajtim me të akuzuarin N.R, me qëllim për t’iu mundësuar përfitim në mënyrë të kundërligjshme kompanive të lartshënuara.”.

Kolegji arrin në përfundim se nga provat e ofruara nuk rezultojnë e provuar se të akuzuarit kanë vepruar me synimin për të i’u siguruar kompanive përfitim të kundërligjshëm, për këtë nuk ekziston ndonjë dëshmi a provë konkrete që vërteton këtë fakt, apo që nga tërësia e tyre dhe rrethanave faktike, të mund të derivonte konkluzioni se të akuzuarit kishin vepruar të motivuar dhe me qëllim që t’i sigurojnë përfitim personave të tjerë.

Sipas pikëpamjes së Kolegjit, një qëllim i tillë mbetet i padëshmuar, i supozuar dhe i paargumentuar. Për më tepër, nuk është provuar ekzistimi i ndonjë raporti i të akuzuarve me kompanitë e lartcekura, nga i cili më pastaj do mund eventualisht të rrjedh deduksioni se mbi bazën e këtyre relacioneve të akuzuarit të kenë vepruar me këtë qëllim.

Përfundimisht, aktgjykimi i atakuar është i paqëndrueshëm nga këndvështrimi i të provuarit, të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë janë të pambështetura në prova dhe faktet e konstatuara, si të tilla janë hipotetike, që shfaqen me rastin e nxjerrjes së konkluzionit se të akuzuarit me veprimet e tyre kishin qëllim të përfitonin personat e tretë. Në këtë situatë faktike, nuk mund të zbatohet dispozita materiale pasi që tiparet subjektive të veprës penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kanë mbetur të paprovuara, andaj nuk mund të zbatohet dispozita materiale e cituar e ligjit penal.

Kolegji thekson se detyrë e një gjykate penale, është të shqyrtoj nëse në veprimet e të akuzuarve manifestohen veprime të natyrë kriminale që bartin pas vetes përgjegjësi penale, dhe jo të shqyrtohet ligjshmëria administrative e vendimeve, akteve e veprimeve të këtyre zyrtarëve, edhe nën supozimin se veprimet e tilla mund të jenë të paligjshme nga pikëpamja administrative prapëseprapë përderisa nuk rezulton se të njëjtat ishin të qëllimshme që operatorëve të i'u sigurohet përfitimi i paligjshëm nuk mund të konsiderohet se kemi të bëjmë me kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohen. Në të kundërtën, vlerësimet e tilla do të ishin jashtë mandatit e funksionit të saj kushtetues dhe ligjor të gjykatës.

Sipas këndvështrimit të Kolegjit, është çështje e ministrive hartimi i politikave brenda fushëveprimtarisë së tyre në kuadër të kornizave të tyre ligjore, më pas menaxhimi i tyre. Çështja e intervenimit të sistemit të drejtësisë penale është një "ultima rei", vetëm nëse veprimet e tilla bien në kundërshtim me legjislacionin penal, për të cilën duhet të sigurohen prova të qarta, se të akuzuarit veprojnë në kundërshtim me detyrat e tyre zyrtare dhe se vendimet e tyre nuk janë në interesin institucional të institucionit në të cilën shërbejnë, por janë të drejtuara në krijimin e përfitimeve të paligjshme për veten apo personave të tjerë, apo të shkakimit të dëmit (në kontekstin e rastit konkret - përfitim personave të tjerë).

Në këtë kontekst, Kolegji sjell në vëmendje se juridiksioni penal, nuk mund të konceptohet si autoritet kompetentë për sanksionimin dhe korrektimin e çfarëdo menaxhimi dhe administrimi jo të duhur, që mund ta bëjnë këto organe dhe zyrtarët e tyre, përmes shkeljeve të normave të tjera të cilat bien në kategorinë e normave ligjore jo penale, konstatimet e shkeljeve të kësaj

natyre, qartazi mbeten jashtë sferës së kompetencave të institucioneve penale, janë mekanizmat e natyrës jo penale që adresojnë kuadratin e çështjeve të tilla.

Për rrjedhojë, në lidhshmëri të çështjes, Kolegji arriti në konkluzionet në pyetjet e ngritura më parë:

a) Nuk rezulton e provuar se të akuzuarit N.R dhe M.K, ishin në dijeni me rastin e hartimit të programit të veçantë për bujqësi, dhe emërimi i grupit punues në përbërje prej 11 anëtarëve, për përgatitjen e investimeve në infrastrukturë rurale si përshkruhet në aktgjykim, se do të aplikonin dhe do të fitonin kompanitë : Konzorciumit “N...” sh.p.k, Konzorciumit “Dh...” sh.p.k, Konzorciumit “D.....”, si dhe Konzorciumit NTP “A.....E...” në P..... dhe se programi e këto veprime të jenë bërë me qëllim që këtyre kompanive të i’u sigurojnë përfitime të kundërligjshme.

b) Nuk rezulton e provuar, të ketë ekzistuar ndonjë raport direkt apo indirekt i të akuzuarave me kompanitë fituese, të shënuara si më lartë.

Përfundimet e cekura janë rezultat i materialit të tërësishëm provues të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, rrjedhimisht, për të ndërtuar përgjegjësinë penale duhet të vërtetohen faktet e tilla, të cilat do të manifestonin aspektin subjektiv të akuzuarave se kishin relacione me kompanitë e tilla në mënyrë direkte apo indirekte, dhe se veprimet e tyre të ndërmarra ishin të sinkronizuara dhe shfaqnin qëllimin kriminal.

Kolegji vëren se të akuzuarit janë akuzuar dhe shpall fajtor për veprën penale të kryer bashkëkryerje. Shtrohet pyetja, cilat janë faktet, rrethanat dhe provat që provojnë ekzistimin e bashkëkryerjes në çështjen konkrete?

Kolegji vlerëson se nuk mjafton vetëm fakti se të akuzuarit ishin në cilësinë e Ministrit në M...e B...P... dhe Zh... R...të Republikës së Kosovës, dhe Sekretar i Përgjithshëm në M...e B...P... dhe Zh... R...të Republikës së Kosovës i përhershëm. Zbatimi i programit të veçantë bujqësor, se do të bëhet përmes këtyre dy funksioneve është jo kontestues, pasi kjo është një rrugë dhe procedurë institucionale e bazuar në hierarkinë e organizimit dhe funksionimit të ministrisë, mirëpo nuk mund nxjerrët konkludimi për bashkëkryerjen i mbështetur vetëm mbi faktin se të akuzuarit mbanin dhe ushtronin këto funksione. Sipas Kolegjit, një rrethanë e tillë është e pamjaftueshme, pa konstatimin edhe të aspekteve tjera subjektive ose rrethanave të natyrës objektive, të cilat do të shpërfaqnin të provuar faktin se tek të akuzuarit kishte marrëveshje për veprime të kordinuara në këtë mënyrë.

Përfundimi

Kolegji arriti në përfundim se nga provat e procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk është provuar se të akuzuarit N.R dhe K.P kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, andaj në kuptim të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së lirohen nga akuza për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par.1 dhe par.2 nënpar.2.1 dhe 2.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Kolegji, ndan pikëpamjen lidhur me shkaktimit të dëmit, dhe dëmtimin e buxhetit. Gjykata e shkallës së parë vërteton lartësinë e dëmit prej euro, duke vlerësuar se mund të kenë humbur edhe fermerët nëse nuk do shpenzohej kjo shumë e të hollave, e cila situatë është e diskutueshme, eventualisht mund të provohej nëse fermerët do ta padisnin MBPZHR-në për dëmin e pësuar konkret, sipas padive individuale në gjykata në procedurë civile.

Në kuptim të nenit 462 par.3 të KPP-se, e dëmtuara Avokatura Shtetërore e Kosovës pranë Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

6. Vendimi për pjesën liruese të aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë

Kolegji gjen se pretendimet ankimore të prokurorit që i referohen pjesës liruese për të akuzuarit Sh.Z, E.Gj, Sh.M, L.Th, L.K dhe A.Z, janë të paqëndrueshme dhe të paargumentuara.

Mbi bazën e vërtetimit të gjendjes së fakteve, gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar edhe ligjin penal, kur të akuzuarit i ka liruar nga akuza për shkak se nuk është vërtetuar se të njëjtit ka kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi që nga provat e administruara nuk kanë rezultuar si të provuara tiparet e kësaj veprë penale.

Kolegji pajtohet me arsyet e dhëna në aktgjykim, për pjesën liruese. Kolegji vëren se akuzuari E.Gj, akuzohet për tejkalimin e kompetencave, me rastin e marrjes së vendimit për formimin e grupit punues për të bërë kontrollin administrativ, vlerësim, miratim dhe kontraktimin e projekteve të masës së infrastrukturës rurale. Në procesin gjyqësor nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë, se i njëjti kishte vepruar me dashje dhe me qëllim të kryhet vepra penale në bashkëkryerje me të akuzuarit N.R, K.P.

Nga faktet e çështjes konstatohet se sipas emailit të N.V për përpilimin e vendimit për ekipin vlerësues për PZHR 2018, gjykata ka vërtetuar se vet drejtori i drejtoratit për miratim të projekteve të zhvillimit rural, në atë kohë N.V, i ishte drejtuar përmes e-mailit drejtorit të administratës publike të AZHB-së M.G dhe në CC ishte dhe E.Gj si UD Kryeshef i AZHB-së, me të cilin kishte kërkuar që të përpilohet ekipi vlerësues për kontroll administrative, duke rekomanduar që në ekipen e parë të jetë L.K, Sh.M dhe në ekipen e dytë të jetë A.Z dhe L.Th

Për rrjedhojë, përmes këtij e-maili vërtetohet fakti se vet drejtori kishte kërkuar hartimin e vendimit të ekipit të kontrollit dhe kishte përcaktuar emrat e personave, pra në rastin konkret edhe emrat e personave të grupit punues që ishin të akuzuar si në pikën II të akuzës. Mbi këtë bazë me të drejtë gjykata e shkallës së parë kishte konkluduar se ky fakt e përjashton dashjen si tipar thelbësor për veprën penale për të cilën akuzohet, ishte kërkesë e drejtorit që të formohej grupi vlerësues për kontroll administrativ nga ana e kryeshefit ekzekutiv tani i akuzuari E.Gj.

Po ashtu për të akuzuarin Sh.Z, nga opinioni ligjor dhe nga dy dëshmitarët Sh.D dhe F.B.K, vërtetohet se i akuzuari Sh.Z nuk kishte dashje apo qëllim për hartimi në programit të veçantë për shkak se i njëjti kishte dhënë opinionin ligjor se ky program nuk përcaktohet me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillimin Rural, e po ashtu edhe gjatë takimeve sipas dëshmitarëve i njëjti e kishte kundërshtuar hartimin e këtij programi, në takimet e grupit punues apo edhe në takimet jo formale me anëtarët e grupit.

Pretendimi i prokurorisë lidhur me faktin se i akuzuari Sh.Z e kishte nënshkruar udhëzimin administrativ si drejtor i departamentit ligjor dhe ishte përgjegjës që ishte miratuar udhëzimi administrativ, ky pretendim është i pabazuar për shkak se nënshkrimi i të akuzuarit ishte rezultat i detyrave dhe përgjegjësi të tij që për secilin akt që nxjerrej nga Departamenti Ligjor, duhej të nënshkruaj nga drejtori, e që në rastin konkret i akuzuari Sh.Z ka qenë drejtor i Departamentit Ligjor në kohën kur është miratuar udhëzimin administrativ UA 09/2018, ndërsa aprovimi përkatësisht hyrja në fuqi e këtij udhëzimi administrativ siç është sqaruar më lartë i njëjti kishte hyrë në fuqi me rastin e nënshkrimit nga ana e ministrit,

Prandaj, gjykata me të drejtë ka ardhur në përfundim se në rastin konkret në asnjë rrethanë nuk është vërtetuar bashkëkryerja, përkatësisht qëllimi i të akuzuarit Sh.Z për të kryer veprën penale së bashku me të akuzuarit N.R dhe K.P siç është akuzuar nga ana e PSRK me aktakuzën që ka qenë objekt i këtij shqyrtimi.

Kolegji në raport me të akuzuarit Sh.M, L.Th, L.K dhe A.Z, pajtohet me të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë, pasi në bazë të provave të proceduara, nuk ka arritur të vërtetoj qëllimin e të akuzuarve për të kryer veprën penale, ngase nuk është provuar që të akuzuarit Sh.M, L.Th, L.K dhe A.Z, të kenë pasur qëllimin për ti dhënë përfitim pasuror të kundërligjshëm kompanive përfituese të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, andaj pretendimet e ankimore të prokurorit janë të pabazuara dhe mbështet arsyet dhe shpjegimet e dhëna në aktgjykim.

Është i paqëndrueshëm pretendimi i PSRK-së se të akuzuarit kundërligjshëm kanë shpallur fitues konzorciumet të përshkruara si në dispozitivin e II-të të aktakuzës, është vërtetuar se të akuzuarit në cilësinë e personave zyrtar kanë vepruar në kuadër të kompetencave dhe detyrave të tyre zyrtare në harmoni me vendimin nr.3403 të dt.08.08.2018, në të cilën janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë lidhur me vlerësimin e dosjeve dhe të njëjtit nuk kishin për kompetencë shpalljen fituese të konzorciumeve, ngase shpallja e përfituesve ishte bërë pas përfundimit dhe vlerësimit të aplikacioneve dhe kjo procedurë, përkatësisht shpallja e përfituesve ishte bërë nga N.V në cilësinë e Drejtorit të Miratimit të Projekteve, të cilin fakt gjykata e ka vërtetuar nga dëshmia e tij.

Prandaj nuk kishte tejkalim të autorizimeve dhe kompetencave për shkak se të akuzuarit kanë qenë të obliguar që të zbatojnë të gjitha dispozitat juridike të UA 09/2018, përfshirë këtu nenin 26 par.3 të tij, por edhe sikurse të vlerësonin gabimisht ndonjë dokument apo kriter të caktuar, vlerësimi i tyre nuk ka qenë obligativ për personin kompetent për shpallje të përfituesve – Drejtorin për Miratimin e Projekteve, i cili ka pasur kompetencë dhe diskrecion të plotë sipas deklaramit të mësipërm dhënë në shqyrtim gjyqësor se në rast se do të gjente ndonjë shkelje në raport me punën e ekipes së kontrollit, i njëjti ka mundur që të kthej dosjen e aplikimit në rivlerësim dhe të rishqyrtohej nga Komisioni i Ankesave.

Sipas aktakuzës së PSRK, të akuzuarit akuzohen se duke vepruar në bashkëkryerje i kanë shpallur fitues konzorciumet si në dispozitivin II të aktakuzës, të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet ligjore sipas udhëzimit administrativ 09/2018 për zbatimin e programit të veçantë për zonat më pak të zhvilluara. Ky pretendim është i paqëndrueshëm, sipas akuzës me rastin e përshkrimit të veprimeve inkriminues të akuzuarave, nuk ishte përcaktuar se me cilat dispozita ligjore të udhëzimit administrativ kishin vepruar të akuzuarit.

Sipas Udhëzimit Administrativ me numër të UA 09/2018, në nenin 26, pika 3, përcaktohet që:

” Nëse një aplikacion dorëzohet nga një grup i kompanive/ kooperativave, kërkesat minimale aplikohen për tërë grupin në tërësi, dhe kompanitë/ kooperativat kanë të drejtë të përdorin referencat e njëra tjetrës”.

Gjykata konsideroi se të akuzuarit me rastin e vlerësimit të aplikacioneve, kishin vlerësuar se aplikuesit kanë pasur të drejtë në bazë të dispozitës së lartcekur ti përdorin referencat e njeri-tjetrit.

Në këtë aspekt, është vlerësuar se të akuzuarit kishin interpretimin se kompanitë kanë pasur të drejtë ti përdorin e referencat e njëra tjetrës me rastin e aplikimit si konzorcium i përbashkët.

Kolegji çmon se ekzistimi i një situatë e tillë juridike natyrshëm nuk paraqet tejkalim apo mos përmbushje të detyrës zyrtare, për shkak se interpretimi i dispozitave të UA 09/2018 ka qenë në kuadër të detyrave dhe kompetencave të tyre si grup punues dhe se nga ana e tyre ishte bërë vetëm vlerësimi i aplikacioneve, nga dosjet e administruara përgjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se nga 7 aplikues ishin vlerësuar nga ekipi i kontrollës, dhe se vetëm 4 subjekte përfituese i kishin plotësuar kriteret sipas thirrjes për aplikim dhe sipas UA 09/2018, dhe se shpallja e përfituesve nuk ishte bërë nga ana e tyre.

Në këtë drejtim nga dosjet e aplikacioneve të përfituesve të granteve, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktin se kompanitë përfituese të granteve ishin shpallur fitues pas aprovimit të kontrollit të terrenit, që ishte bërë nga inspektoret e MBPZHR-së, më pas përfundimisht ishin aprovuar nga Drejtoria Kompetente për Miratim të Projekteve-përkatësisht nga personi kompetent – Drejtori i kësaj drejtorie z.N.V. Në kuptim të kësaj, vërtetohet fakti se të akuzuarit në kuadër të kompetencave të tyre nuk kanë pasur shpalljen fituese të konzorciumeve siç pretendohet nga ana e PSRK-së, mirëpo si detyrë të vetme kanë pasur vlerësimin e aplikacioneve në aspektin administrativ në mbështetje të UA 09/2018, e që nga kjo rezulton se kjo rrethanë nuk paraqet ndonjë tejkalim apo mos përmbushje të detyrave të tyre zyrtare, për shkak se të njëjtit unanimisht kishin vendosur se kompanitë-konzorciumet që kishin aplikuar i plotësonin kriteret sipas UA dhe thirrjes për aplikim.

Pretendimi i PSRK-së lidhur me atë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale si në aktakuzë, për arsye se asnjëra nga konzorciumet fituese nuk kanë qenë të regjistruara në ARKB dhe AUV, një pretendim të tillë vlerësohet si pabazuar, pasi që nga analizimi i shkresave të lëndës dhe dosjeve të përfituesve të granteve si dhe nga analizimi i bazës ligjore, gjegjësisht nga Ligjin Nr. 06/L - 016 për Shoqëritë Tregtare, nenin 5, i cili përcakton llojet e shoqërive tregtare të cilat duhen të

regjistrohen, sipas kësaj dispozite nuk është përcaktuar që konzorciumet duhet të regjistrohen si shoqëri tregtare në ARBK. Nga analizimi i thirrjes për aplikimin e hapur nga MBPZHR, për “ Programin e veçantë për investimet në infrastrukturën rurale dhe ngritja e aftësive konkurruese në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë përmes përfshirjes së komunitetit në zhvillimin rural në regjionin e Mitrovicës së Veriut”, gjegjësisht në pikën 4, ku përcaktohen kriteret e përbashkët të pranueshmërisë, mes të tjerash theksohet “Nëse një aplikacion dorëzohet nga një grup i kompanive/kooperativave, kërkesat minimale aplikohen për tërë grupin si tërësi, dhe kompanitë /kooperativat kanë të drejt të përdorin referencat e njëra tjetrës”.

Lidhur me vlerësimin e dosjeve që ishte bere nga ana e të akuzuarve për konzorciumin fitues “N...” SH.P.K, në dosje ekziston se kompanitë 1. “N...” SH.P.K si përfaqësuese e konzorciumit kishin lidhur Marrëveshje me numër LRP.nr.2423, REF.nr.340/2018 të datës 18.06.2018, e lidhur në mes: 2.Sofra Distribution sh.p.k, 3.Catering Prishtina SH.P.K, Blerimi – M SH.P.K), për aplikim në thirrjen e hapur për përfitimimin e grantit “Ndërtimi i tregut modern për prodhime bujqësore” në Prishtinë.

Në dosje shihet qartë përkatësisht vërtetohet se “N...” Sh.p.k ishte e regjistruar ne ARBK dhe këtë fakt e vërteton certifikata e regjistrimit te biznesit me numër 70866404, e cila është e regjistruar nga data 24.07.2012.

Pretendimi i PSRK-së se konzorciumi “N...” Sh.p.k, nuk ishte e regjistruar në AVUK, mirëpo nga shikimi i dosjes të konzorciumit “N...” Sh.p.k, gjykata ka gjetur se në kuadër të marrëveshjes që kishin lidhur si konzorcium i përbashkët, kompania Blerimi-M”, kishte qenë e regjistruar në AVUK e cila kishte poseduar vendimin nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AVUK), me numër te Ref: të datës

Gjykata ka ardhur në përfundim se të akuzuarit kishin vlerësuar se kompania “N...” Sh.p.k, i plotësonte kriteret, përkatësisht ishte e regjistruar në ARBK dhe AVUK, për shkak se edhe sipas thirrjes për aplikim, gjegjësisht pikën 4, shprehimisht theksohet se kompanitë/kooperativat kanë të drejtë ti përdorin referencat e njëra tjetrës që në rastin konkret tek secili konzorcium fitues i grantit, kriteri i aplikueshëm ka qenë që njëra nga kompanitë që kanë lidhur marrëveshje për konzorcium të jetë e regjistruar në AVUK, e që rezulton se ky kriter ishte vlerësuar për të gjitha kompanitë/konzorciumet fituese të grantit sipas vlerësimit të të akuzuarve.

Prandaj, qartazi konfirmohet se Konzorciumet fituese me marrëveshjet e noterizuara të lidhura me njëra tjetrën, kanë aplikuar si grup i përbashkët në thirrjen e hapur për aplikim dhe interesat e tyre ishin përfitimi i granteve sipas thirrjes për aplikim që kishte bërë AZHB.

7. Përfundimi

Kolegji arrin në përfundimin se tek të akuzuarit nuk është provuar se kanë bërë tejkalim të autorizimeve ligjore, me rastin e vlerësimi të kriteve të konzorciumeve fituese si dhe nuk provohet të ketë ekzistuar qëllimi që kompanive përfituese të i'u sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, andaj nuk provohen përgjegjësia penale për veprën për të cilën janë akuzuar, rrjedhimisht ankesa e PSRK-së është e pabazuar.

Në kuptim të nenit 453 par.1 të KPP-së shpenzimet e procedurës penale të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës.

Nga arsyet e sipërcekura e në bazë të nenit 403 par. 1 dhe 2 të dhe nenit 401 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Departamenti Special

APS.nr.54/23

Datë: 25.04.2024

Bashkëpunëtorja profesionale

Syzana Goxhuli

Kryetare e kolegjit,

Afërdita Bytyçi

Anëtarët e kolegjit:

Bashkim Hyseni

Vaton Durguti
